



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK



V E N D I M

Nr. 66, datë 02.10.2018

PËR SHITESË FONDI NË BUXHETIN E BASHKISË SHKODËR

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e datës 02.10.2018, me propozim të kryetarit të bashkisë, mbështetur në nenin 35 pika 1 shkronja “d”, nenin 54 shkronja “dh”, nenin 55 pika 3 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenin 20 pika 1 dhe 5 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, pika 190 e udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat statndarte të zbatimit të buxhetit, udhëzimit plotësues nr. 2, datë 19.1.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018, udhëzimit nr. 8, datë 17.2.2003 “Për evidentimin, regjistrimin, përdorimin dhe raportimin e financimeve të huaja në kuadrin e projekteve dhe marrëveshjeve me donator të huaj, ligjin nr. 66/2017 “Për ratifikimin e marrëveshjes për bashkëpunimin teknik ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Zhvillimit Urban dhe Qeverisë së Konfederatës Zviceriane, përfaqësuar nga Agjencia Zviceriane për Zhvillim dhe Bashkëpunim për programin e Zhvillimit Rajonal për Shqipërinë, kontratës së Grantit nr. 11408 prot, datë 12.7.2018 mes bashkisë Shkodër dhe programit të Zhvillimit Rajonal Shqipëri, VKB nr. 85, datë 26.12.2017 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2018 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2018-2020 të bashkisë Shkodër”,

V E N D O S I:

1. Miratimin e shtesës së fondit në buxhetin e bashkisë Shkodër me burim financimi donacion në llogari jashtë llogarive të thesarit në programin 6260 “shërbime publike vendore”, zëri “shërbime kapitale të trupëzuara”, në shumën **53,402 Euro** (*pesëdhjetë e tre mijë e katërqind e dy*), konvertuar në lek sipas kursit të këmbimit të ditës që do të transferohet fondi, me burim financimi RDPA Programi i Zhvillimit Rajonal Shqipëri.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Miratur në datën 2.10.2018

Shpallur në datën 8.10.2018

Sekretar i këshillit



Suel Hadri

KRYETAR



Xhemal BUSHATI



Pr. 1460

12.10.2018



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODER
SEKTORI JURIDIK

Nr. 1233/1 prot

Shkodër, më 18.10.2018

LËNDA: Lidhur me vendimin nr. 66, datë 02.10.2018 të Këshillit Bashkiak Shkodër.

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të detyrave funksionale të ligjit Nr.107/2016 "Për Prefektin", neni 8, gërma a, të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 36, pika 2, neni 54, pika dh. neni 55 pika 3, të ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore". neni 20, të ligjit nr. 9963, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të Udhëzimit të MFE nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", pika 190, të Udhëzimit MF nr. 8, dt. 17.02.2003 "Për evidentimin, regjistrimin, përdorimin dhe raportimin e financimeve të huaja në kuadrin e projekteve dhe marrveshjeve me donator të huaj". të ligjit nr. 66/2017 "Për ratifikimin e marrveshjes së bashkëpunim teknik ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Zhvillimit Urban dhe Qeverisë së Konfederatës Helvetike, përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim për programin e Zhvillimit Rajonal për Shqipërinë", të VKB nr. 85, datë 26.12.2017 "Për buxhetin e bashkisë Shkodër për vitin 2018 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2018-2020". shqyrtoi **VKB Shkodër nr. 66, datë 02.10.2018 "Për shtesën e fondit prej 53.402 euro, në buxhetin e Bashkisë Shkodër, të miratuar me VKB Shkodër 85/2017, në prog. 6260/shërbime publike vendore, me burim financimi RDPA"** (Programin i Zhvillimit Rajonal në Shqipëri).

Pas shqyrtimit, Prefekti ju autorizon procedimin e mëtejshëm.

Me respekt.

PREFEKTI

Çesk MILLIA

